

KERKESE PER OFERTE

Ekspert për zhvillimin e analizës së të dhënave dhe konkluzioneve të dy sondazheve online, para dhe pas zgjedhjeve vendore 2023

Projekti: “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”

Instituti e Studimeve Politike (ISP), do të implementojë projektin “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit(KSHH) organizatë lider si dhe në partneritet me BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare(QQ).Ky projekt mbështetet financiarisht nga Ambasada Britanike.

Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Qëllimi i shërbimit

Kërkohet bashkëpunimi me një ekspert i jashtëm për zhvillimin e analizës së të dhënave dhe konkluzioneve të dy sondazheve online, para dhe pas zgjedhjeve vendore 2023. Eksperti është përgjegjës analizimin e të dhënave të përfituara nga sondazhet, evidentimin e gjetjeve dhe konkluzioneve.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

Profili i ekspertit:

- Të paktën dy vjet përvojë profesionale përkatëse në një funksion të ngjashëm- analizimi të dhënash, punë kërkimore dhe nxjerrjen e rekomandimeve;
- Përvojë kërkimore (desk-research) dhe adresim rekomandimesh;
- Aftësi të shkëlqyera analizuese dhe hulumtuese;
- Shumë i/e organizuar në nivel detyre dhe projekti;

Edukim/Eksperiencë Profesionale/Gjuhë të huaja:

- Diplomë universitare për Shkenca Mediatike, Sociale , Politike, Filologjike apo Juridike;
- Minimum 3 vjet eksperiencë profesionale në fushën përkatëse;
- Eksperienca të mëparshme në fushën e analizës së të dhënave dhe adresimin e rekomandimeve.

Aftësitë individuale

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi analitike dhe mendim kritik;
3. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afateve të vendosura;
4. Të ketë aftësi të punojë nën presionin e kohës;

Detyra dhe përgjegjësitë

Eksperti i përzgjedhur për këtë pozicion duhet të bashkëpunojë ngushtazi me Drejtuesin e projektit, Koordinatorin dhe ekspertët e përfshirë në projekt.

Eksperti është përgjegjës për:

- Analizën e të dhënave për sondazhin përpara zgjedhjeve vendore 2023;
- Analizën e të dhënave për sondazhin pas zgjedhjeve vendore 2023;
- Evidentimin e gjetjeve dhe zhvillimin e analizës mbi bazën e tyre;
- Hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të dala nga pyetëtori;
- Ofrimin e angazhimit profesional në bashkëpunim me stafin e ISP për sugjerime, paqartësi, materiale shtesë, etj;
- Adresimin e gjetjeve, reflektimin e sugjerimeve të ISP, në variantin përfundimtar të dokumentit;
- Dorëzimin e timesheet-eve përkatëse në fund të çdo muaji;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e ofruar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

Procedura e Aplikimit:

Ekspertët e interesuar janë të lutur të japin ofertat e tyre që të dërgojnë deri në datën 30.01.2023, ora 12.00 në formë elektronike në adresën e e-mailit të ISP contactaips@gmail.com, me postë ose dorazi me zarf të mbyllur me mbishkrim sipër zarfit: “Ofertë për ekspert analizë sondazhesh” në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Curriculum Vitae ;
3. Oferta financiare (të gjitha taksat përfshirë);
4. Punë ngjashme të realizuara më parë nga kandidati.

Procedura e Vlerësimit

Kualifikimet dhe eksperiencia juaj duhet të jenë konform kërkesave të specifikuar në Termat e Referencës. CV juaj do të vlerësohet për përputhjen e eksperiencës dhe kualifikimeve tuaja me kriteret e vendosura dhe që lidhen me kualifikime të përgjithshme/ eksperiencia të mëparshme, përshtatshmëria me ToR në projekt, ofertë financiare.

Aplikantët mund të paraqesin çdo pyetje shtesë dhe/ose kërkesë për sqarime në formë elektronike në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com.

Periodha e angazhimit: është 15 dite brenda periudhës shkurt - shtator 2023, kurse fondi limit është 3000 GBP për të gjithë periudhën e angazhimit.

Sinqerisht,
Instituti i Studimeve Politike

